



**Numri:** KSC-BC-2020-06  
**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,  
Rexhep Selimit, Jakup Krasniqit**

**Vendos:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Pjesëmarrësi parashtrues:** Prokurori i Specializuar

**Data:** 17 nëntor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i redaktuar publik i**

**'Kërkesës për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave në lidhje me to', parashtrimi**

**KSC-BC-2020-06/F00005 i datës 28 maj 2020**

**me shtojcën e redaktuar publike 1 dhe shtojcat publike 2-3**

---

**Zyra e Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**

Dejvid Hupër

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**

Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

## I. HYRJE

1. Më 25 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') kërkoi që gjykatësi i procedurës paraprake i Dhomave të Specializuara të Kosovës ('DHSK') të konfirmonte një aktakuzë ('Aktakuza') kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ('të dyshuarit') në lidhje me vepra penale të kryera në Kosovë dhe pjesë të Shqipërisë midis marsit 1998 dhe shtatorit 1999.<sup>1</sup> Në atë kohë, ZPS-ja paralajmëroi gjithashtu parashtrimin e kërkesës aktuale për lëshimin e fletarrestimeve dhe masat përkatëse.<sup>2</sup>

2. Duke mbajtur parasysh nenet [REDAKTUAR] të Ligjit <sup>3</sup> dhe rregullat [REDAKTUAR] të Rregullores,<sup>4</sup> ZPS-ja i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake: (a) të lëshojë fletarrestime për të dyshuarit dhe urdhra përkatës për transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të DHSK-së në vendin pritës ('njësia e paraburgimit'); (b) të autorizojë kontrollimin e tyre, të pronave të tyre dhe sekuestrumin; (c) [REDAKTUAR]; (d) të urdhërojë mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave; dhe (e) të urdhërojë mosnxjerrjen e përkohshme të Aktakuzës dhe dokumenteve në lidhje me të.

## II. PARAQITJE E FAKTEVE

3. Në këtë pjesë paraqiten faktet në lidhje me domosdoshmërinë e arrestimit dhe transferimit të të dyshuarve, si dhe të masave të mosnxjerrjes që kërkohen.

---

<sup>1</sup> Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim, KSC-BC-2020-06/F00002, 25 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (me tri shtojca).

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06/F00002, para.5. *Shih gjithashtu* Vendim mbi kërkesën e Prokurorit të Specializuar për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, KSC-BC-2020-06/F00004, 27 maj 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (që autorizon 9.000 fjalë për kërkesën aktuale).

<sup>3</sup> Ligji nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'). Përveç nëse specifikohet ndryshe, të gjitha referencat për "neni/nenet" janë në lidhje me Ligjin.

<sup>4</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev2/2020, 5 korrik 2017 ('Rregullorja'). Përveç nëse specifikohet ndryshe, të gjitha referencat për "rregulla/rregullat" janë në lidhje me Rregulloren.

4. Të dyshuarit ushtrojnë ndikim shumë të madh tek ish pjesëtarë të UÇK-së dhe përgjithësisht në Kosovë.<sup>5</sup> Individualisht dhe bashkërisht, ata kanë aftësinë të manipulojnë organet e qeverisë për të shmangur dhe penguar procedurat kundër tyre,<sup>6</sup> si dhe të mobilizojnë baza të reja të përkrahjes, duke përfshirë ata që më parë kanë qenë nën komandën e tyre në UÇK dhe grupe si Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së ('OVL-UÇK').

5. OVL-UÇK-ja, me anëtarësi prej mbi 40.000 vetë, më parë ka bërë peticion për shfuqizimin e Ligjit<sup>7</sup> dhe ka kundërshtuar aktivisht përpjekjet e mëhershme për ndjekjen penale të ish-anëtarëve të UÇK-së për krime të luftës, ndër të tjera përmes protestave kërcënuese, demonstratave dhe mosbindjes civile.<sup>8</sup> Para do kohe, këshilltari i qeverisë Shkëlzen Gashi thjesht deklaroi se individë të caktuar nga radhët e UÇK-së kryen krime dhe për pasojë - në frymën e gjuhës së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të viteve 1998-1999<sup>9</sup> - ai: (i) u quajt 'kolaboracionist' dhe përkrahës i serbëve si nga Jakup Krasniqi,<sup>10</sup> po ashtu edhe nga anëtarë drejtues të OVL-UÇK-së;<sup>11</sup> (ii) u bë objekt i kërcënimeve me vdekje;<sup>12</sup> dhe përballë reagimit të ashpër, (iii) u shkarkua nga pozita e këshilltarit.<sup>13</sup>

6. Shembulli i GASHIT pasqyron një atmosferë mosndëshkimi dhe frikësimi që të dyshuarit kanë mundësuar dhe inkurajuar në mënyrë aktive. Vetë të dyshuarit kanë një histori të gjatë qëndrimi armiqësor ndaj përgjegjësive për krime të kryera gjatë luftës ose

<sup>5</sup> Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, para. 1-12.

<sup>6</sup> Tashmë ka tregues të qartë se pjesë të caktuara të Qeverisë së Kosovës nuk do të bashkëpunojnë në mirëbesim me hetimet e ZPS-së. [REDAKTUAR].

<sup>7</sup> Artikull i Agjencisë Franceze të Lajmeve 'AFP', 15 shkurt 2018, në anglishte gjendet në <https://www.france24.com/en/20180215-kosovos-guerrilla-heroes-fear-war-crimes-court>.

<sup>8</sup> *Balkan Insight*, 24 qershor 2013, në anglishte gjendet në <https://balkaninsight.com/2013/06/24/kla-ex-fighters-determined-to-continue-objection-of-eulex/>.

<sup>9</sup> *Shih* KSC-BC-2020-06/F00002/A02, f.10-18.

<sup>10</sup> Shtojca 2, Pjesa II F, 24 prill 2020, postim i Jakup Krasniqit në *Facebook*. Për nga koha dhe përmbajtja, ky mesazh duket qartë se ka lidhje me Shkëlzen Gashin.

<sup>11</sup> *Shih* Shtojca 2, Pjesa III A dhe C.

<sup>12</sup> *Shih* Shtojca 2, Pjesa III B.

<sup>13</sup> *BIRN*, Serbeze Haxhijaj, *Kosovo PM Sacks Adviser for Criticising Wartime Guerilla*/Kryeministri i Kosovës shkarkon këshilltarin për kritikimin e guerilëve të luftës 26 prill 2020, në anglishte gjendet në <https://balkaninsight.com/2020/04/26/kosovo-pm-sacks-adviser-for-criticising-wartime-guerrillas/>.

çfarëdo hetimi të tyre. Që prej fillimit, sikurse parashtrohet në Aktakuzë, si anëtarë të UÇK-së dhe të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, të dyshuarit ishin anëtarë të një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët, qëllimi i përbashkët i së cilës përfshinte frikësimin e paligjshëm, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës ndaj atyre që konsideroheshin kundërshtarë dhe eliminimin e tyre.<sup>14</sup> Për më tepër, asnjëri prej të dyshuarve nuk hetoi krimet kundër kundërshtarëve të kryera nga persona që ishin nën kontrollin efektiv të tyre.<sup>15</sup>

7. Kohët e fundit, ata kanë sulmuar publikisht mandatin e DHSK-së,<sup>16</sup> duke e akuzuar ndër të tjera se është gjykatë diskriminuuese<sup>17</sup> dhe duke e etiketuar si ‘padrejtësi historike’.<sup>18</sup> Në 2017 u raportua gjerësisht se anëtarë të PDK-së - parti politike e udhëhequr më parë nga Thaçi dhe tani nga Veseli – ishin orvatur të siguronin përkrahje për shfuqizimin e DHSK-së.<sup>19</sup> Në vitin 2019, Thaçi lloboi për ‘reformimin’ e DHSK-së, duke pohuar se i takon Qeverisë së Kosovës të vendosë për ‘mandatin, funksionimin dhe vendndodhjen gjeografike’ të DHSK-së dhe ZPS-së.<sup>20</sup> Që prej atëherë, Thaçi ka gënjer

<sup>14</sup> Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, para.32.

<sup>15</sup> Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, para. 53-55.

<sup>16</sup> *Shih, për shembull*, [REDAKTUAR] (rrëfen reagimin e Thaçit ndaj publikimit të raportit të Komisionit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, me titull: Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë, Doc.12462, 7 janar 2011 (‘Raporti i Këshillit të Evropës’)).

<sup>17</sup> Presidenti Republikës së Kosovës, Fjalim i Presidentit Thaçi drejtuar qytetarëve dhe ushtarëve të FSK-së, 5 dhjetor 2017, në anglishte gjendet në <https://president-ksgov.net/en/speeches/?offset=10>; *Balkan Transitional Justice*, Petrit Çollaku, *Kosovo Opposition Rejects New War Crimes Court/Opozita kosovare kundërshton gjykatën e re për krime të luftës*, 6 janar 2015, në anglishte gjendet në <https://balkaninsight.com/2015/01/06/opposition-parties-against-special-court/>.

<sup>18</sup> Agjencia e lajmeve AP, Lllazar Semini, *Kosovo president slams international war crimes court/Presidenti i Kosovës kritikon gjykatën ndërkombëtare për krime të luftës*, 14 shkurt 2018, në anglishte gjendet në <https://apnews.com/8c1fd1a013284f12b02b1337bc53334c>.

<sup>19</sup> RFE/RL/Radio Evropa e Lirë (‘REL’), *Interview with Hashim Thaci/Intervistë me Hashim Thaçin*, 27 dhjetor 2017, në anglishte gjendet në <https://www.rferl.org/a/kosovo-thaci-legislation-abolishing-war-crimes-court/28943894.html> (ku Thaçi thotë që ai nuk i ‘inkurajon deputetët’ të miratojnë një ligj të tillë, por shton se do ta nënshkruajë çdo vendim të kuvendit të Kosovës lidhur me këtë çështje); RTK, *Thaci: MPs decide on Special Court, their initiative is legal/Thaçi: Deputetët vendosin mbi Gjykatën Speciale, iniciativa e tyre është e ligjshme*, 28 dhjetor 2017, në anglishte gjendet në <https://www.rtklive.com/en/news-single.php?ID=10335>.

<sup>20</sup> Shtojca 2, Pjesa I A, 29 nëntor 2019, Letër e Hashim Thaçit drejtuar Majkëll Pompeo, raportuar në *Gazeta Express*.

publikisht për shkallën e përfshirjes së tij personale me ZPS-në.<sup>21</sup> Jakup Krasniqi si pjesë e diatribës shumëvjeçare kundër DHSK-së,<sup>22</sup> më 24 prill 2020 postoi si vijon: '[ç]do shqiptar që D. Marti e quan PATRIOT, që është në shërbim të kryeministrit ose në çfarëdo pozite tjetër, është kolaboracionist dhe në shërbim të politikës gjenocidale të [Sllobodan] Millosheviqit!' <sup>23</sup> Njëpërmjet deklaratave dhe veprimeve të këtilla, të dyshuarit po i përdorin pozitat e tyre të pushtetit dhe ndikimit për të sabotuar dhe penguar mandatin e DHSK-së.

8. Për më tepër, disa nga të dyshuarit kanë një të kaluar të qartë të ndërhyrjes ndaj ose pengimit të zbatimit të ligjit, dhe tashmë ka prova të orvatjeve për ndërhyrje në punën hetimore të ZPS-së. Për shembull, anëtarë të SHIK-ut, vartës të Kadri Veselit<sup>24</sup> dhe anëtarit të identifikuar me emër të NKP-së, Azem Sylës, janë të implikuar në përcjelljen, kërcënimin dhe ofrimin e ryshfetit dëshmitarëve që dëshmojnë kundër ish-anëtarëve të UÇK-së në proceset para TPNJ-së.<sup>25</sup>

9. Po kështu, qeveria amerikane vuri Rexhep Selimin në listën e zezë për përfshirjen e tij të mundshme në pengimin e zbatimit të UNSC 1244 (Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për themelimin e UNMIK-ut)<sup>26</sup> dhe ndaj tij Departamenti i Thesarit i Shteteve të Bashkuara ka vendosur sanksione.<sup>27</sup> Për më tepër, persona që punonin për Rexhep Selimin<sup>28</sup> u implikuan në tentimin për vrasjen [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].<sup>29</sup> Brenda një ore pas këtij tentimi për vrasje, Selimi u përpoq të

<sup>21</sup> Shtojca 2, Pjesa I B, *Zëri*, 1 prill 2020, Thaçi flet nëse është intervistuar prej Dhomave të Specializuara. Thaçit faktikisht iu dorëzua fletëthirja e ZPS-së më 17 nëntor 2019 dhe për herë të parë u paraqit për intervistë në Hagë më 12 dhjetor 2019.

<sup>22</sup> *Shih* Shtojca 2, Pjesa II.

<sup>23</sup> Shtojca 2, Pjesa II F, 24 prill 2020, postim i Jakup Krasniqit në *Facebook*.

<sup>24</sup> Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, para.5.

<sup>25</sup> [REDAKTUAR].

<sup>26</sup> Shtetet e Bashkuara, Urdhër Ekzekutiv 13219 për bllokimin e pasurive të personave që kërcënojnë përpjekjet ndërkombëtare të stabilizimit në Ballkanin Perëndimor, 26 qershor 2001, 66 F.R. 34777.

<sup>27</sup> Zyra e Shteteve të Bashkuara për Kontrollin e Pasurive të Huaja, Lista e Personave Posaçërisht të Përcaktuar dhe të Bllokuar, 22 maj 2020, f.1042, versioni i fundit i listës gjendet në <https://sanctionssearch.ofac.treas.gov>.

<sup>28</sup> [REDAKTUAR].

<sup>29</sup> [REDAKTUAR].

kontaktonte njërin prej të dyshuarve,<sup>30</sup> dhe më pas kontaktoi një polic kosovar dhe i kërkoi atij që të shkonte të merrte [REDAKTUAR] që dyshohej se ishte përdorur në tentimin për vrasje.<sup>31</sup> Një hetues [REDAKTUAR] bëri shënim në dosje se '[ë]shtë [...] tejet shqetësues fakti që Rexhep Selimi mund të telefonojë kur të dojë një polic të SHPK-së dhe t'i kërkojë atij që të shfrytëzojë pozitën e vet për marrjen e provave që mund të jenë përdorur në kryerjen e veprave penale'.<sup>32</sup>

10. Kohët e fundit, zyrtarë qeveritarë besnikë të Thaçit dhe Veselit kanë kryesuar pagesa korruptive të qeverisë për dëshmitarë të mundshëm të ZPS-së. Ministri (i atëhershëm) i Drejtësisë, Abelard Tahiri, emëroi Driton Lajçin shef të Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencialë në Proceset Gjyqësore para Dhomave të Specializuara ('Divizioni') në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.<sup>33</sup> Abelard Tahiri ka punuar gjatë me Thaçin në detyra të ndryshme [REDAKTUAR].<sup>34</sup> [REDAKTUAR].<sup>35</sup> Para marrjes së detyrës së shefit të Divizionit, Lajçi punonte si këshilltar i Veselit<sup>36</sup> dhe njihej me Thaçin për më se 25 vjet,<sup>37</sup> meqenëse kishte qenë anëtar i këshillit iniciues të PDK-së së Thaçit në vitin 1999.<sup>38</sup>

11. Nën drejtimin e Lajçit, Divizioni shqyrtonte kërkesa për pagesën e 'shpenzimeve juridike dhe të udhëtimit' të pretenduara të të dyshuarve që paraqiten para ZPS-së, edhe pse DHK-ja ua kompenson të intervistuarve ato shpenzime.<sup>39</sup> Pagesat e Divizionit duket se nuk bëhen në bazë të kriterëve të njëtrajtshme dhe kanë shumë pak lidhje me shpenzimet legjitime të kryera. Për shembull, [REDAKTUAR], mori [REDAKTUAR]<sup>40</sup> në

<sup>30</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

<sup>31</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

<sup>32</sup> [REDAKTUAR].

<sup>33</sup> [REDAKTUAR]; Ligji nr. 05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencialë në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.

<sup>34</sup> [REDAKTUAR].

<sup>35</sup> [REDAKTUAR].

<sup>36</sup> [REDAKTUAR].

<sup>37</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

<sup>38</sup> Artikull i BBC-së, 14 tetor 1999, 020881-020882.

<sup>39</sup> Neni 42(4).

<sup>40</sup> [REDAKTUAR].

lidhje me një intervistë njëditëshe në Hagë. [REDAKTUAR].<sup>41</sup> Nuk ka asnjë provë [REDAKTUAR] t'i ketë paraqitur Divizionit një kërkesë zyrtare për mbështetje financiare para marrjes së kësaj shume,<sup>42</sup> ndërkohë që kërkesa të të tjerëve – disa prej të cilëve u intervistuan për ditë me radhë nga ZPS-ja – ende nuk ishin miratuar as muaj më vonë.<sup>43</sup>

12. Thaçi dhe Veseli janë mbështetur në ndihmën e personave besnikë si Lajçi gjithashtu edhe për marrjen e raporteve në lidhje me hollësitë e hetimit të ZPS-së. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>44</sup>

13. [REDAKTUAR]:

- a. [REDAKTUAR].
- b. [REDAKTUAR]
- c. [REDAKTUAR].<sup>45</sup>

14. Për më tepër, pasi [REDAKTUAR] pranoi t'u përgjigjej pyetjeve të ZPS-së në vend të mbajtjes së heshtjes, ka prova që tregojnë se Thaçi u përpoq të sigurote që avokati që përfaqësonte [REDAKTUAR], të mos u caktohej për përfaqësim të intervistuarve të tjerë.<sup>46</sup>

15. Në një rast tjetër, pothuajse menjëherë pasi [REDAKTUAR] e kishte bërë publike që do të intervistohet nga ZPS-ja, Thaçi dhe Veseli [REDAKTUAR].<sup>47</sup> I pyetur nga Thaçi për gjendjen e familjes, [REDAKTUAR].<sup>48</sup> Shumë shpejt pas kësaj, [REDAKTUAR] u takua me [REDAKTUAR] dhe i ofroi përfitime të ndryshme, [REDAKTUAR].<sup>49</sup> [REDAKTUAR] ia bëri të qartë se kjo ofertë ishte në emër të Presidentit [Thaçit].<sup>50</sup>

---

<sup>41</sup> [REDAKTUAR].

<sup>42</sup> *Shih* [REDAKTUAR]. *Por, shih* [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

<sup>43</sup> [REDAKTUAR].

<sup>44</sup> *Shih* Shtojca 1, Deklaratë e [REDAKTUAR].

<sup>45</sup> [REDAKTUAR].

<sup>46</sup> [REDAKTUAR].

<sup>47</sup> [REDAKTUAR].

<sup>48</sup> [REDAKTUAR].

<sup>49</sup> [REDAKTUAR].

<sup>50</sup> [REDAKTUAR].

16. Për të siguruar që bashkanëtarët e tjerë të NKP-së të jenë në anën e tij përballë hetuesve të ZPS-së, Hashim Thaçi nuk përdor vetëm Divizionin. Ai organizoi që [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], të vinin kontakt [REDAKTUAR] para intervistës së këtij të fundit me ZPS-në, për t'i përcjellë porosinë 'që [Thaçi] donte ta kontaktonte [REDAKTUAR] ose t'i jepte njëfarë udhëzimi'.<sup>51</sup>

17. Orvatjet për të ushtruar ndikim tek dëshmitarë të mundshëm, përfshirë tek anëtarë të identifikuar me emër të NKP-së, kanë përfshirë gjithashtu edhe punësimin e tyre në pozita qeveritare. Sylejman Selimi doli nga burgu më 25 janar 2019 dhe menjëherë më pas, përkatësisht më 29 janar 2000, atij iu dorëzua fletëthirrja e ZPS-së. Brenda 72 orëve pas marrjes në dorëzim të fletëthirrjes,<sup>52</sup> ai u punësua si 'këshilltar' i qeverisë. Pas indinjatës publike, Selimi u lirua nga detyra e këshilltarit shumë shpejt pas intervistës së tij me ZPS-në në shkurt 2019,<sup>53</sup> por jo para se të kishte marrë mbi 15.000 euro rrogë<sup>54</sup> për pothuajse kurrfarë pune të bërë.<sup>55</sup> Po në atë periudhë kohore, përkatësisht në janar 2019, ZPS-ja intervistoi anëtarin e identifikuar me emër të NKP-së, Rrustem Mustafën. Më 14 shkurt, Thaçi e punësoi atë si këshilltar me një rrogë prej 18.000 euro në vit; megjithatë, asgjë nga kjo nuk ishte bërë publike para se të zbulohej në një raport të Agjencisë së Kosovës kundër Korrupsionit.<sup>56</sup>

<sup>51</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

<sup>52</sup> Fakti që Sylejman Selimi do të merrej në pyetje nga ZPS-ja tashmë ishte raportuar publikisht pas kontaktit fillestar të ZPS-së me të. *Shih* Kossev, Izvor KoSsev, Sylejman Selimi hospitalized two days before the trip to the Hague, received two days off for New Year's celebration/Sylejman Selimi shtrohet në spital dy ditë para udhëtimit për në Hagë, iu dhanë dy ditë të lira për festën e vitit të ri', 9 janar 2019, në anglishte gjendet në <https://kossev.info/sylejman-selimi-hospitalized-two-days-before-the-trip-to-the-hague-received-two-days-off-for-new-year-celebration/>.

<sup>53</sup> *Shih* BIRN, Përparim Isufi, Kosovo PM Sacks Adviser Convicted of War Crimes/Kryeministri i Kosovës shkarkon nga detyra këshilltarin e dënuar për krime lufte, 4 qershor 2019, në anglishte gjendet në <https://balkaninsight.com/2019/06/04/kosovo-pm-sacks-adviser-convicted-of-war-crimes/>.

<sup>54</sup> Shtojca 3, Raport i Agjencisë kundër Korrupsionit për Sylejman Selimin, f.3.

<sup>55</sup> [REDAKTUAR].

<sup>56</sup> *Shih* BIRN, Taulant Osmani, Kosovo President Secretly Appoints War Crimes Convict as Adviser/Presidenti i Kosovës emëron fshehurazi si këshilltar të dënuarin për krime lufte, 7 qershor 2019, në anglishte gjendet në <https://balkaninsight.com/2019/06/06/kosovo-president-secretly-appoints-war-crimes-convict-as-adviser/>.



18. Secili prej të dyshuarve ka mjetet, motivin dhe mundësinë për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve, ose ndryshe për të shmangur apo penguar procesin gjyqësor. Fakti që incidente të tilla janë duke ndodhur para konfirmimit të një aktakuze tregon qartë rrezikun që mund të sjellë lënia e të dyshuarve në liri. Sikurse duket qartë nga ndjekjet penale të mëparshme, duke përfshirë të anëtarëve të identifikuar me emër të NKP-së dhe bashkëpunëtorëve të tjerë të ngushtë të të dyshuarve, ekziston një atmosferë endemike e ndërhyrjes dhe frikësimit të rëndë të dëshmitarëve në procese gjyqësore të ish-anëtarëve të UÇK-së. Shembujt e dhënë më poshtë që lidhen kryesisht me vendndodhjet e krimeve të pretenduara në Aktakuzë janë ilustrues të një tendence shqetësuese më të gjerë.<sup>57</sup>

19. Më [REDAKTUAR] – [REDAKTUAR]<sup>58</sup> – u qëllua për vdekje, [REDAKTUAR] – [REDAKTUAR] – u plagos rëndë.<sup>59</sup> Që të dy ishin dëshmitarë në gjykimin e çështjes [REDAKTUAR]<sup>60</sup> që kishte filluar [REDAKTUAR] para gjuajtjes me armë zjarri dhe ishte në lidhje me krimet në qendrën e ndalimit në [REDAKTUAR].<sup>61</sup> Shtëpia e [REDAKTUAR] më parë gjithashtu ishte sulmuar me bomba, kurse incidente të tjera gjuajtjesh me armë zjarri kishin ndodhur edhe kundër dëshmitarëve të tjerë.<sup>62</sup> Sikurse u shpreh kryegjykatësi në atë gjykim, ekzistonte një ‘shkallë e jashtëzakonshme e frikësimit të dëshmitarëve’<sup>63</sup> që ‘dëmtoi ecurinë e [këtij] procesi’.<sup>64</sup>

20. Më [REDAKTUAR], ish anëtari i UÇK-së [REDAKTUAR] – [REDAKTUAR]<sup>65</sup> – u gjet [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. Ai u kishte dhënë deklarata hetuesve

<sup>57</sup> Përveç incidenteve që diskutohen më poshtë, *shih*, në lidhje me Likocin (Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, Lista A, Vendndodhja nr.14.1): [REDAKTUAR]; në lidhje me Llapashticën (Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, Lista A, Vendndodhja nr.10.3): [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR]; në lidhje me Zllashin (Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, Lista A, Vendndodhja nr.11.4): Parashtrimi i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesa në lidhje me të, 14 shkurt 2020, KSC-BC-2020-05/F00002, para. 9, 11.

<sup>58</sup> [REDAKTUAR].

<sup>59</sup> [REDAKTUAR].

<sup>60</sup> [REDAKTUAR].

<sup>61</sup> [REDAKTUAR].

<sup>62</sup> [REDAKTUAR].

<sup>63</sup> [REDAKTUAR].

<sup>64</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR] (ku përmenden incidente të ndryshme të ndërhyrjes).

<sup>65</sup> [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR] për krime lufte, dhe ishte dëshmitari kryesor në çështjen gjyqësore kundër [REDAKTUAR], dhe të tjerëve, për krime në lidhje me qendrën e ndalimit në [REDAKTUAR].<sup>66</sup> Ekzistojnë prova që [REDAKTUAR] u përball me kërcënime nga më të rëndat në vitet para vdekjes së tij – [REDAKTUAR].<sup>67</sup>

21. Çështja gjyqësore *Limaj dhe të tjerët* kishte të bënte ndër të tjera me përgjegjësinë penale të anëtarit të identifikuar me emër të NKP-së, Fatmir Limajt, për krimet e kryera në qendrën e ndalimit në Llapushnik.<sup>68</sup> [REDAKTUAR] refuzoi të dëshmonte në atë çështje për shkak të kërcënimeve, [REDAKTUAR].<sup>69</sup> [REDAKTUAR], i shkuan në derë të shtëpisë dhe e kërcënuan me vdekje nëse do të dëshmonte kundër Fatmir Limajt.<sup>70</sup> Gjatë gjykimit të çështjes *Limaj dhe të tjerët* pati edhe një vendim fajësie për shpërfillje të gjykatës, për veprime të tjera të ndikimit korruptiv mbi një dëshmitar të mbrojtur.<sup>71</sup>

22. Çështja gjyqësore *Haradinaj dhe të tjerët* kishte të bënte ndër të tjera me përgjegjësinë penale të anëtarit të identifikuar me emër të NKP-së, Lahi Brahimajt, për krime të kryera në qendrën e ndalimit në Jabllanicë<sup>72</sup> dhe në mënyrë të ngjashme rezultoi në vendime fajësie për shpërfillje të gjykatës në lidhje me zbulimin e identitetit<sup>73</sup> dhe ndikimin korruptiv<sup>74</sup> ndaj dëshmitarëve të mbrojtur. Në Aktgjykimin e vet, Dhoma Gjyqësore në çështjen *Haradinaj dhe të tjerët* theksoi se:<sup>75</sup>

[G]jatë gjithë procesit, Dhoma Gjyqësore hasi në vështirësi të konsiderueshme për marrjen e dëshmimeve nga një numër i madh dëshmitarësh. Shumë dëshmitarë përmendën frikën si arsye parësore pse nuk dëshironin të paraqiteshin para Dhomës Gjyqësore për të dëshmuar. Dhoma Gjyqësore fitoi përshtypje të fortë se procesi po zhvillohej në një atmosferë ku dëshmitarët ndiheshin

<sup>66</sup> [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

<sup>67</sup> [REDAKTUAR].

<sup>68</sup> Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, Lista A, Vendndodhja nr.1.1.

<sup>69</sup> [REDAKTUAR].

<sup>70</sup> [REDAKTUAR].

<sup>71</sup> TPNJ, Prokurori k. Beqajt, IT-03-66-T-R77, Aktgjykim në lidhje me akuzat për shpërfillje të gjykatës, 27 maj 2005.

<sup>72</sup> Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, Lista A, Vendndodhja nr.3.1.

<sup>73</sup> TPNJ, Prokurori k. B. Haxhiut, IT-04-84-R77.5, Aktgjykim në lidhje me akuzat për shpërfillje të gjykatës, 24 korrik 2008.

<sup>74</sup> TPNJ, Prokurori k. Haraqisë dhe Morinës, IT-04-84-R77.4-A, Aktgjykim, 23 korrik 2009.

<sup>75</sup> TPNJ, Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, IT-04-84-T, Aktgjykim, 3 prill 2008, para. 6.

të pasigurtë. Shkak ishin një sërë faktorësh specifikë për Kosovën, për shembull bashkësitë e vogla të Kosovës, lidhjet e ngushta familjare dhe fisnore që e bënë të vështirë ruajtjen e anonimitetit. Palët vetë ishin dakord se në Kosovë ekzistonte një gjendje sigurie e paqëndrueshme e cila ishte veçanërisht e dëmshme për dëshmitarët.

23. Në çështjen *Demaku dhe të tjerët*, anëtarët e identifikuar me emër të NKP-së, Sabit Geci dhe Sylejman Selimi, u akuzuan për krime në lidhje me qendrën e ndalimit në Likoc.<sup>76</sup> Ekzistojnë prova se midis 2013 dhe 2015, persona që bashkëpunonin me të akuzuarit në atë çështje i ofruan [REDAKTUAR], si nxitje që të tërhiqte deklaratën [REDAKTUAR] dhe të jepte dëshmi të rreme.<sup>77</sup> Në mënyrë të ngjashme, [REDAKTUAR] i ofruan [REDAKTUAR] për të dhënë dëshmi të rreme, e kërcënuan, [REDAKTUAR].<sup>78</sup> Në fund, [REDAKTUAR]<sup>79</sup> edhe [REDAKTUAR]<sup>80</sup> [REDAKTUAR].

24. Në çështjen *Balaj dhe të tjerët*, që kishte të bënte me krimet e kryera në Zonën Operative të Dukagjinit,<sup>81</sup> gjatë gjykimit pati tentime për vrasjen e dëshmitarëve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].<sup>82</sup> [REDAKTUAR] pësoi lëndime kur persona të panjohur qëlluan [REDAKTUAR].<sup>83</sup> [REDAKTUAR].<sup>84</sup> Këto veprime, së bashku me shembuj të mosdhënies së informacionit thelbësor prej dëshmitarëve, nxitën gjykatësin hetues të deklaronte se ‘asnjëherë më parë nuk kisha marrë kaq [shumë] informacion lidhur me kërcënime ndaj dëshmitarëve apo të paktën orvatje për të ushtruar ndikim ndaj

---

<sup>76</sup> Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, Lista A, Vendndodhja nr.14.1.

<sup>77</sup> [REDAKTUAR].

<sup>78</sup> [REDAKTUAR].

<sup>79</sup> [REDAKTUAR].

<sup>80</sup> [REDAKTUAR].

<sup>81</sup> Aktakuza përfshin pretendime në lidhje me Zonën Operative të Dukagjinit. *Shih* Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, para.43. Gjithashtu, qendra e ndalimit në Jabllanicë (Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, Lista A, Vendndodhja No.3.1) ndodhej në Zonën Operative të Dukagjinit.

<sup>82</sup> [REDAKTUAR].

<sup>83</sup> [REDAKTUAR].

<sup>84</sup> [REDAKTUAR].

tyre'.<sup>85</sup> [REDAKTUAR] pas vendimit për fajësi penale në atë çështje,<sup>86</sup> [REDAKTUAR] u vra [REDAKTUAR].<sup>87</sup> [REDAKTUAR] më pas, persona të armatosur qëlluan dhe vranë [REDAKTUAR].<sup>88</sup>

25. [REDAKTUAR] ka deklaruar se ish anëtarë të UÇK-së i ofruan ryshfet të konsiderueshëm për të heshtur dhe më vonë urdhëruan vrasjen e tij.<sup>89</sup> [REDAKTUAR] punonte për [REDAKTUAR],<sup>90</sup> të cilin, [REDAKTUAR], e drejtonte [REDAKTUAR].<sup>91</sup> [REDAKTUAR].

26. Në të vërtetë, kur flasin me ZPS-në, dëshmitarë të shumtë të mundshëm - ndër të cilët viktimat, ish anëtarë të UÇK-së<sup>92</sup> dhe punonjës të mëparshëm të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, si për shembull OSBE-ja,<sup>93</sup> – shprehin frikë ose rikujtojnë përvojat e kaluara të frikësimit të dëshmitarëve. Gjatë gjithë këtij hetimi, dëshmitarët kanë shprehur në mënyrë të përsëritur frikën e tyre të madhe për atë që mund t'u ndodhë nëse i rrëfejnë të vërtetën ZPS-së.<sup>94</sup> Ky është manifestimi më i fundit i këtij problemi të kahershëm dhe të vazhdueshëm. Sipas një raporti të OSBE-së për gjykimet në Kosovë, gjatë dhjetë viteve të para të pasluftës, problemi i mbrojtjes së dëshmitarëve 'ka dëmtuar ndjekjen penale të rasteve të krimeve të luftës ndoshta më

---

<sup>85</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu UNMIK, Prosecutor v. Balaj et al., PN.222/2002, Detention Decision of Supreme Court of Kosovo/Prokurori k. Balajt dhe të tjerëve, Vendim për paraburgim i Gjykatës Supreme të Kosovës, 13 shtator 2002, SPOE00085767-00085776, f. SPOE00085769 (lë në fuqi zgjatjen e masës së paraburgimit në atë çështje: '[I]ista e gjatë e kërcënimeve të drejtuara kryesisht kundër jetës dhe sigurisë së dëshmitarëve mund të konsiderohet lehtësisht nga gjykata si ndikim i fuqishëm i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i të akuzuarve në Dukagjin dhe Kosovë, ndikim ky që do të jetë edhe më i madh po qe se të akuzuarit do të gjykohen në liri').*

<sup>86</sup> [REDAKTUAR].

<sup>87</sup> [REDAKTUAR].

<sup>88</sup> [REDAKTUAR].

<sup>89</sup> [REDAKTUAR].

<sup>90</sup> [REDAKTUAR].

<sup>91</sup> Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, para.5. [REDAKTUAR]. *Shih.* [REDAKTUAR]. *Shih përgjithësisht* [REDAKTUAR].

<sup>92</sup> *Shih, për shembull,* [REDAKTUAR].

<sup>93</sup> *Shih Shtojca 1, Deklaratë e* [REDAKTUAR].

<sup>94</sup> *Shtojca 1, Deklaratë e* [REDAKTUAR].

shumë se çdonjë nga problemet e tjera', veçanërisht në çështjet gjyqësore kundër ish anëtarëve të UÇK-së.<sup>95</sup>

### III. FLETARRESTIMET

27. Paraburgimi është masa më e efektshme për të kufizuar aftësinë e të dyshuarve për t'u arratisur ose, ndryshe për të penguar shtrirjen e juridiksionit të DHSK-së, hetimin apo procesin gjyqësor, dhe/ose për të kryer vepra të tjera penale.

28. Kushtet e nenit 41(6) për arrestimin e të dyshuarve janë përmbushur.

29. Aktakuza dhe materiali mbështetës demonstrojnë se ekziston dyshim i bazuar<sup>96</sup> se të dyshuarit kryen vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, sikurse parashtrohet në Aktakuzë dhe në përputhje me nenin 41(6)(a).

30. Për më tepër, megjithëse për lëshimin e një fletarrestimi mjafton përmbushja e vetëm njërit prej këtyre kushteve, të dyshuarit duhet të paraburgosen mbi bazën e të tre kushteve të nenit 41(6)(b) ('Kushtet e nenit 41(6)'). Ekzistojnë 'arsye të artikulueshme për të besuar' se: (1) të dyshuarit mund të arratisen; (2) të dyshuarit do të pengojnë ecurinë e procedimit penal, ndër të tjera përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit; dhe (3) natyra e rëndë e veprës penale, ose mënyra apo rrethanat e kryerjes së saj dhe karakteristikat personale të të dyshuarve, sjellja e tyre në të kaluarën, mjedisi dhe kushtet në të cilat jetojnë, ose rrethanat e tjera personale, tregojnë për rrezikun e përsëritjes së veprës penale prej tyre ose të kryerjes së një vepre penale që kanë kërcënuar se do ta kryejnë. Për përcaktimin e ekzistencës së njërit prej këtyre rreziqeve, nevojitet të vlerësohet mundësia përkundrejt pashmangshmërisë së materializimit të tyre.<sup>97</sup>

<sup>95</sup> OSCE, Kosovo's War Crimes Trials: An Assessment Ten Years On (1999-2009)/OSBE, Gjykimet për krime të luftës në Kosovë: Vlerësim dhjetë vjet më pas (1999-2009), maj 2010, në anglishte gjendet në <https://www.osce.org/kosovo/68569?download=true>, f.26; [REDAKTUAR]. *Ngjashëm, shih* Raporti i Këshillit të Evropës, para. 21, 25-26, 69 (thekson vështirësitë e hasura gjatë përgatitjes së raportit).

<sup>96</sup> Kosovë, Kodi i Procedurës Penale nr.04/L-123 i vitit 2012, neni 19(1.9).

<sup>97</sup> [REDAKTUAR]; ICC, *Prosecutor v. Bemba Gombo et al.*, ICC-01/05-01/13-558, Judgment on the appeal of Mr Aime Kilolo Musamba against the decision of Pre-Trial Chamber II of 14 March 2014 entitled "Decision

## A. RREZIKU I ARRATISJES

31. Me të kuptuar për krimet e rënda për të cilat akuzohen – krime që mund të dënohen edhe me burgim të përjetshëm<sup>98</sup> – të dyshuarit kanë motiv të fortë për të shmangur gjykimin dhe rrezikun e dënimit. Motivi i tyre për arratisje mund të ndikohet më tej edhe nga dijenia e tyre për vendimet e raportuara publikisht për fajësi penale të disa ish anëtarëve të lartë të UÇK-së për disa nga krimet e paraqitura në Aktakuzë, ndër të cilët anëtarë të identifikuar me emër të NKP-së, si për shembull Lahi Brahimaj, Rustem Mustafa dhe Sabit Geci.

32. Të gjithë të dyshuarit kanë mjetet, motivin dhe mundësinë për t'iu shmangur drejtësisë. Që të gjithë janë ish komandantë të lartë të UÇK-së dhe liderë politikë aktualë apo të mëparshëm në Qeverinë e Kosovës.<sup>99</sup> Që të gjithë kanë qasje në fonde të konsiderueshme dhe mund mobilizojnë lehtësisht një rrjet të gjerë përkrahësish dhe zyrtarësh qeveritarë, përfshirë persona me ekspertizë në lëmin e sigurisë, policisë dhe inteligjencës.

33. Të gjithë të dyshuarit kanë pasaporta që do t'u mundësonin të arratiseshin menjëherë në shtete për ku nuk nevojitet vizë.<sup>100</sup> Thaçi dhe Veseli udhëtojnë gjithandej në nivel ndërkombëtar, kurse Selimi dhe Krasniqi vizitojnë rregullisht Shqipërinë. Kosova ka marrëveshje të ekstradimit vetëm me një numër të vogël shtetesh të tjera, që është domethënëse duke marrë parasysh që ky është një nga mekanizmat e bashkëpunimit me DHSK-në.<sup>101</sup> Marrë së bashku me numrin e vendeve që thjesht nuk e njohin Kosovën si shtet, është krejtësisht e lehtë për të dyshuarit të udhëtojnë në mënyrë të ligjshme në juridiksione që nuk kanë kurrfarë detyrimi për transferimin e tyre në DHSK. Të dyshuarit

---

on the 'Demande de mise en liberte provisoire de Maitre Aime Kilolo Musamba'"/GJPN, Prokurori k. Bemba Gombos dhe të tjerëve, Aktvendim mbi apelin e z. Aime Kilolo Musambas kundër vendimit të Dhomës së Procedurës Paraprake II të 14 marsit 2014 me titull "Vendim mbi Kërkesën për lirim të përkohshëm të z. Maitre Aime Kilolo", 11 korrik 2014, para.107.

<sup>98</sup> Neni 44(1).

<sup>99</sup> Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, para. 1-12.

<sup>100</sup> Hashim Thaçi ka pasaportë diplomatike dhe Jakup Krasniqi ka pasaportë shqiptare.

<sup>101</sup> Neni 55(2); Rregulla 208.

kanë padyshim edhe lidhjet për t'u larguar nga Kosova përmes kufijve të paligjshëm, që e bën dorëzimin e pasaportave prej tyre një zgjidhje të papërshtatshme.

#### B. RREZIKU I PENGIMIT TË ECURISË SË PROCEDIMIT PENAL

34. Të dyshuarit kanë qenë udhëheqës të lartë të UÇK-së, ende mbajnë pozita pushteti dhe ndikimi në Kosovë dhe akuzohen, ndër të tjera, për kryerje përmes një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në vitet 1998-1999 në vende të ndryshme në Kosovë dhe Shqipëri veriore. Një numër shumë i madh provash janë mbledhur dhe vazhdojnë të mblidhen nga burime të shumta, përfshirë nga jashtë shtetit. Hetimet kanë qenë mjaft të ndërlikuar dhe me gjasë të tilla do të jenë edhe procedura paraprake dhe gjykimi i ardhshëm. Këto hetime dhe procedura po kryhen në një atmosferë të frikës dhe frikësimit të dëshmitarëve. Në rrethana të këtilla, paraburgimi është i domosdoshëm, të paktën deri sa të dëgjojnë dëshmitarët dhe sigurohen provat.<sup>102</sup>

35. Rreziku që të dyshuarit të mobilizojnë përkrahësit e tyre për të penguar hetimin dhe procedimin penal është qartësisht real. Kjo mund të shihet nga qëndrimi i tyre ndaj hetimeve dhe procedimeve penale të shkuara e të tanishme lidhur me krimet e kryera nga ish anëtarë të UÇK-së,<sup>103</sup> si dhe nga atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve që shoqëron hetime dhe procedime të tilla.<sup>104</sup> Në periudhën që mbulon Aktakuza, të dyshuarit ishin eprorë të shumë dëshmitarëve të mundshëm të ZPS-së. Të dyshuarit ende mbajnë pozita të larta pushteti dhe/ose ndikimi. Ata kanë mjetet, motivin dhe mundësinë

<sup>102</sup> *Shih, ngjashëm*, ECtHR, *Podeschi v. San Marino*, 66357/14, Judgment/GJEDNJ, Podeski k. San Marinos, Aktgjykim, 13 prill 2017, para. 147-149; ECtHR, *Mkhitarjan v. Russia*, 46108/11, Judgment/GJEDNJ, Mkhitarjan k. Ruisë, Aktgjykim, 5 shkurt 2013, para. 94-99; ECtHR, *Sopin v. Russia*, 57319/10, Judgment/GJEDNJ, Sopin k. Ruisë, Aktgjykim, 18 dhjetor 2012, para. 43-47. *Shih gjithashtu*, EULEX, *Prosecutor v. Sabit Tafil Geci et al.*, 117/2013, Ruling on Appeals Against Extension of Detention on Remand/Prokurori k. Sabit Tafil Gecit dhe të tjerëve, Vendim mbi apelet kundër zgjatjes së masës së paraburgimit, 22 shkurt 2013, SITF00177479-SITF00177485, f. SITF00177484 (para. 21) (arsyet për paraburgimin e një personi duhet para së gjithash të bazohen në rrethanat e atij personi, por 'mund të merren parasysh edhe rrethana të tjera, përfshirë edhe problemi i njohur i frikësimit të dëshmitarëve në çështje penale kundër ish anëtarëve të UÇK-së në Kosovë, me kusht që kjo të mos jetë e vetmja arsye').

<sup>103</sup> *Shih* para. 6-9 më lart.

<sup>104</sup> *Shih* para. 18-26 më lart.

që të ndërhyjnë ndaj dëshmitarëve, viktimave ose bashkëkryesve, dhe ndryshe të përpiqen të pengojnë procesin. Siç u argumentua më lart, përpjekje të tilla duket se kanë filluar që paraprakisht.<sup>105</sup>

36. Në kuadër të përpjekjeve të tyre të vazhdueshme për delegjtimimin e DHSK-së (ndër të tjera përmes propozimit të masave të cilat efektivisht do ta shfuqizonin atë),<sup>106</sup> veprimet e të dyshuarve - marrë së bashku me pozitat ndikuese të tyre dhe tensionet e brendshme në Kosovë – padyshim që do të inkurajojnë përpjekjet e atyre që orvaten të pengojnë hetimin e ZPS-së. Të dyshuarit vetë janë të aftë të provokojnë trazira publike në qoftë se gjykojnë se kjo është në interes të tyre.

37. Gjatë gjyqimit, të dyshuarit do të mësojnë gjithsesi identitetin e dëshmitarëve kundër tyre, çka i ekspozon lehtësisht këta dëshmitarë ndaj një rreziku edhe më të madh frikësimi. Disa dëshmitarë mund të shpërngulen me vendbanim, por jo të gjithë prej tyre do të pajtohen me një masë të tillë mbrojtëse. Po kështu, veçanërisht në rrethana të një gjykimi të anëtarëve të lartë të UÇK-së, masat e tjera mbrojtëse nuk do të mund të trajtojnë plotësisht rrezikun e ndërhyrjes dhe frikësimit.<sup>107</sup> Për më tepër, krimet e rënda të luftës dhe kundër njerëzimit që pretendohen në këtë çështje do të tërheqin vëmendjen e një publiku të konsiderueshëm në Kosovë, ku pasojat e luftës ndjehen ende dhe procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe politike është në vijim e sipër.<sup>108</sup>

38. Në përputhje me sa më lart, në këtë çështje, paraburgimi dhe mundësia e mëpasshme e monitorimit dhe, sipas nevojës, kufizimit të kontakteve të të dyshuarve me njëri-tjetrin, me anëtarë të pretenduar të NKP-së dhe bashkëkryes, me viktimat dhe

<sup>105</sup> *Shih* para. 10-17 më lart.

<sup>106</sup> *Shih* para.7 më lart.

<sup>107</sup> *Shih* para.22 më lart.

<sup>108</sup> *Shih, për shembull, UNMIK, Report of the Secretary General, S/2019/461/Raport i Sekretarit të Përgjithshëm, 3 qershor 2019, në anglishte gjendet në [https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/s\\_2019\\_461.pdf](https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/s_2019_461.pdf). *Shih, ngjashëm, ECtHR, Milanković and Bošnjak v. Croatia, 37762/12 & 23530/13, Judgment/GJEDNJ, Millanković dhe Boshnjak k. Kroacisë, Aktgjykim, 26 prill 2016, para. 148-156.**



persona të tjerë, janë të domosdoshme për të zvogëluar rrezikun e ndërhyrjes së tyre ndaj dëshmitarëve ose, ndryshe, të pengimit të procesit gjyqësor.<sup>109</sup>

#### C. RREZIKU I KRYERJES SË VEPRAVE TË TJERA PENALE

39. Krahas natyrës kriminale të vetvetishme të ndërhyrjes së mundshme ndaj administrimit të drejtësisë të argumentuar në bazë të kriterit të mësipërm, të dyshuarit janë qartësisht të aftë të orkestrojnë veprime të dhunës.

40. Të dyshuarit akuzohen për ndërmarrje kriminale të përbashkët kundër atyre që ishin ose perceptoheshin si kundërshtarë të UÇK-së.<sup>110</sup> Atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve që dëshmuuan kundër anëtarëve të UÇK-së tregon se rreziku i veprimeve të dhunës ndaj kundërshtarëve të UÇK-së vazhdon të jetë i pranishëm edhe sot e kësaj dite.<sup>111</sup> Ekziston rrezik i konsiderueshëm se të dyshuarit do të organizojnë përsëri kryerjen e krimeve të dhunës ndaj atyre që perceptohen si kundërshtarë të tyre. Rrjedhimisht, urdhërimi i paraburgimit të të dyshuarve është masa e vetme e arsyeshme për trajtimin e këtij rreziku.

#### D. TRANSFERIMI NË OBJEKTIN E PARABURGIMIT TË DHSK-SË

41. Duke mbajtur parasysh kërkesën e vet për caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës,<sup>112</sup> ZPS-ja i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake që të urdhërojë transferimin e të dyshuarve në njësinë e paraburgimit, në përputhje me rregullën 50(1)-(2).

<sup>109</sup> *Shih, ngjashëm*, ECtHR, *Baranowski v. Poland*, 39742/05, Judgment/GJEDNJ, Baranovski k. Polonisë, 2 tetor 2007, para.47.

<sup>110</sup> Aktakuza, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, para.32.

<sup>111</sup> *Shih* para. 18-26 më lart.

<sup>112</sup> KSC-BC-2020-06/F00002, para.4.

## IV. KONTROLLIMI DHE SEKUESTRIMI

42. ZPS-ja kërkon që në kuadër të fletarrestimeve, gjykatësi i procedurës paraprake të autorizojë ZPS-në dhe/ose autoritetet zbatuese të fletarrestimeve që në bashkëpunim me ZPS-në:

- a. të kontrollojnë të dyshuarit, vendin e arrestimit dhe vendbanimet, zyrat dhe automjetet e tyre; dhe
- b. të sekuestrojnë çfarëdo provash që besohet se janë përdorur në, janë në lidhje me ose mund të jenë prova relevante për: (a) krimet e paraqitura në Aktakuzë, në veçanti prova që lidhen me veprimtarinë e të dyshuarve midis viteve 1998 dhe 1999, marrëdhëniet ose ndërveprimet e tyre me UÇK-në dhe/ose Qeverinë e Përkohshme të Kosovës ose me anëtarë të tyre, apo me viktimë, dëshmitarë ose bashkëkryes të pretenduar; (b) orvatjet e kohëve të fundit për ndërhyrje në administrimin e drejtësisë; dhe [REDAKTUAR].<sup>113</sup> Ndër sende të tilla mund të përfshihen: shënime nga kontakte apo mbledhje, të dhëna financiare ose pronësore, ditarë, regjistra, vendime, fotografi, videoincizime dhe audioincizime, urdhra, udhëzime, direktiva, raporte, politika, protokolle apo rregullore, si dhe kompjuterë, telefona dhe pajisje të tjera që logjikisht mund të pritet se përmbajnë prova relevante.

43. Ekziston dyshim i bazuar se si ish udhëheqës në UÇK, të dyshuarit kanë kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, si dhe dyshim i bazuar se ata mund të kenë me vete apo në vendbanimet, zyrat ose automjetet e tyre, prova të domosdoshme për hetimin.<sup>114</sup> Gjithashtu, duke mbajtur parasysh rrezikun e ndërhyrjes dhe pengimit, ndër të tjera sikurse përshkruhet më lart,<sup>115</sup> çfarëdo provash që posedojnë

---

<sup>113</sup> [REDAKTUAR].

<sup>114</sup> Rregulla 37(2)(a), (3). *Shih gjithashtu* nenet 35(2)(b) dhe 39(3) dhe rregullën 48(2).

<sup>115</sup> *Shih* Pjesën III.B më lart.

të dyshuarit nuk do të mund të sigurohen në mënyrë tjetër. Kontrollimi dhe sekuestrimi në kuadër të arrestimit të tyre janë e vetmja masë e efektshme për nevojat e hetimit.<sup>116</sup>

44. Cenimi që do t'u shkaktohej të drejtave të të dyshuarve për privatësi dhe pronë është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit, dhe masa hetimore nuk eliminon thelbin e atyre të drejtave.<sup>117</sup> ZPS-ja do ta përshtatë kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit dhe/ose do t'u përcjellë informacionin dhe udhëzimet e nevojshme autoriteteve të tjera që mund të ndihmojnë në kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit, për të garantuar kryerjen e tyre në një mënyrë që përjashton informacion që nuk parashikohet të jetë i rëndësishëm, dhe e cila është në përputhje me garancitë mbrojtëse të përcaktuara në rregullën 39.

45. ZPS-ja kërkon autorizim që të mbajë në ruajtje çfarëdo prove të sekuestruar (i) për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar vlerësimin e provave; dhe (ii) në qoftë se provat gjykohen relevante, afati i autorizimi të zgjatet për aq kohë sa mund të jetë e nevojshme për hetimet dhe procedurat gjyqësore.

V. [REDAKTUAR]

46. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>118</sup> [REDAKTUAR].

47. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>119</sup> [REDAKTUAR].

48. [REDAKTUAR],<sup>120</sup> [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>121</sup> [REDAKTUAR]<sup>122</sup> - [REDAKTUAR],<sup>123</sup> [REDAKTUAR].

49. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

---

<sup>116</sup> Rregullat 31(1)(b), 37(1).

<sup>117</sup> Rregulla 31(1)(c).

<sup>118</sup> [REDAKTUAR].

<sup>119</sup> [REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

<sup>120</sup> [REDAKTUAR].

<sup>121</sup> [REDAKTUAR].

<sup>122</sup> [REDAKTUAR].

<sup>123</sup> [REDAKTUAR].

50. [REDAKTUAR].<sup>124</sup>
51. [REDAKTUAR].<sup>125</sup> [REDAKTUAR].<sup>126</sup> [REDAKTUAR].
52. [REDAKTUAR].
53. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].<sup>127</sup> [REDAKTUAR].<sup>128</sup>

## VI. MOSNXJERRJA E PËRKOHSHME E IDENTITETIT TË DËSHMITARËVE DHE VIKTIMAVE

54. Sikurse parashtrohet më lart, ekziston rrezik real, ndër të tjera, i ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe viktimave<sup>129</sup> që, në përputhje me rregullën 105, përbën rrethana të veçanta që përlligjin mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave të përfshirë në këtë proces deri kur të jenë urdhëruar masat e duhura mbrojtëse. Këtu përfshihen dëshmitarët dhe viktimat e identifikuar në Aktakuzë, në materialet mbështetëse [REDAKTUAR]. Në përputhje me sa më lart dhe pavarësisht rrezikut që të dyshuarit mund gjithsesi të deduktojnë identitetin e disa dëshmitarëve të mundshëm, ZPS-ja kërkon që në pajtim me rregullën 80 dhe 105, gjykatësi i procedurës paraprake të urdhërojë si më poshtë:

- a. mosnxjerrjen për publikun të emrit dhe informacionit që zbulon identitetin e një dëshmitari apo viktime të përmendur;
- b. të autorizojë ZPS-në që të bëjë redaktimin e identitetit dhe informacionit identifikues të dëshmitarëve dhe viktimave të përmendura, si dhe t'u caktojë atyre pseudonime të përkohshme, para nxjerrjes së këtij informacioni për të dyshuarit ose publikun;
- c. kjo mosnxjerrje e përkohshme të mbetet në fuqi deri në një urdhër të mëtejshëm të gjykatësit të procedurës paraprake mbi kërkesën e ZPS-së, ose

---

<sup>124</sup> [REDAKTUAR].

<sup>125</sup> [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

<sup>126</sup> [REDAKTUAR].

<sup>127</sup> [REDAKTUAR].

<sup>128</sup> [REDAKTUAR].

<sup>129</sup> Pjesa II më lart.

pasi të ketë dëgjuar ZPS-në. Duke mbajtur parasysh se vetëm caktimi i pseudonimit, me shumë gjasë, do të jetë masë e pamjaftueshme për të parandaluar identifikimin e dëshmitarëve të cenueshëm nga ana e të dyshuarve, ZPS-ja kërkon që t'i mundësohet të bëjë redaktime, ose ndryshe të dëgjohet para nxjerrjes së një informacioni të tillë ([REDAKTUAR]).

## VII. MOSNXJERRJA E AKTAKUZËS DHE DOKUMENTEVE E INFORMACIONIT NË LIDHJE ME TË

55. Vazhdimi i mosnxjerrjes së Aktakuzës dhe informacionit në lidhje me të është i domosdoshëm në këtë fazë për garantimin e integritetit të procesit dhe mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave. Sikurse parashtrohet më lart, ekziston rrezik real që të dyshuarit, ndër të tjera, të arratisen, të ndërhyjnë ndaj dëshmitarëve dhe viktimave dhe të kryejnë vepra të tjera penale, që në përputhje me rregullën 88(2) demonstroi arsye të vlefshme që përlligjin mosnxjerrjen e përkohshme për publikun të Aktakuzës dhe dokumenteve dhe informacionit në lidhje me të, deri në një urdhër të mëtejshëm.

## VIII. DORËZIMI DHE ZBATIMI

56. ZPS-ja i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake që fletarrestimet dhe urdhrat e transferimit, së bashku me autorizimin për kontrollim dhe sekuestrim, t'ia transmetojë ZPS-së për dorëzim dhe zbatim në bashkëpunim me Administratoren. [REDAKTUAR]. Në bashkëpunim me Administratoren, ZPS-ja është autoriteti kompetent më i përshtatshëm për dorëzimin dhe/ose zbatimin e këtyre urdhrave.

57. Duke i kushtuar vëmendjen e duhur nevojës për të vepruar në përputhje me të drejtat themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, ZPS-ja do t'i zbatojë këto urdhra duke marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave themelore të të dyshuarve dhe atyre të viktimave/dëshmitarëve. Çdo ndërhyrje në të drejtat që ndikohen

prej këtyre masave do të kufizohet vetëm në atë që është absolutisht e domosdoshme.<sup>130</sup>

Menjëherë pas kryerjes së arrestimeve, të dyshuarit do të informohen për të drejtat që u takojnë në bazë të Ligjit.

58. ZPS-ja kërkon autorizim që t'i bëjë të ditur urdhrat për aq sa është e nevojshme dhe e domosdoshme për zbatimin e tyre.

## IX. KLASIFIKIMI

59. Ky parashtim dhe shtojcat e tij dorëzohen për protokollim si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, në përputhje me rregullat 85(4) dhe 86(2).

## X. MASAT E KËRKUARA

60. Për arsyet e lartpërmendura, ZPS-ja i kërkon gjykatësit të procedurës paraprake:
- a. të lëshojë fletarrestime për të dyshuarit dhe urdhra përkatës për transferimin e tyre, sikurse kërkohet në pjesët III dhe VIII më lart;
  - b. të autorizojë kontrollimin dhe sekuestrimin me kushtet e kërkuara në pjesët IV dhe VIII më lart;
  - c. [REDAKTUAR];
  - d. të urdhërojë mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave, me kushtet e kërkuara në pjesën VI më lart; dhe

---

<sup>130</sup> Për shembull, në vendin e kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit, ZPS-ja ka ndërmend të ndalojë përkohësisht komunikimet elektronike jo të rëndësishme. Kjo është absolutisht e domosdoshme sepse, nëse planifikohet kryerja e një numri arrestimesh dhe/ose kontrollimesh në lidhje me disa të dyshuar rreth së një njëjtës kohë, të dyshuarit e tjerë mund të informohen dhe paralajmërohen se është duke u kryer një kontrollim, çka vë në rrezik operacionin më të gjerë. *Shih ECtHR, Cacuci and S.C. Virra & Cont Pad S.R.L. v. Romania, 27153/07/GJEDNJ*, Cacuci dhe S.C. Virra & Cont Pad S.R.L. k. Rumanisë, 17 janar 2017, para. 65-67. ZPS-ja parashikon gjithashtu mundësinë që për arsye të sigurisë dhe ruajtjes së provave, kontrollimi i pronave të tyre mund të kryhet pa praninë e të dyshuarve. Gjithsesi, për aq sa është e realizueshme dhe në përputhje me rregullën 39(1)(c)-(d), ZPS-ja do të marrë masa për të njoftuar avokatët mbrojtës të dyshuarve dhe për t'u dhënë atyre mundësi të arsyeshme për të qenë të pranishëm, në qoftë se logjikisht mund të pritet prania e tyre, si dhe për të siguruar praninë e një vëzhguesi të pavarur. *Shih, ngjashëm, [REDAKTUAR]*.

- e. të urdhërojë mosnxjerrjen e përkohshme të Aktakuzës dhe dokumenteve dhe informacionit në lidhje me të, me kushtet e kërkuara në pjesën VII më lart.

**Numri i fjalëve në origjinal: 5692**

\_\_\_\_\_/nënshkrim/\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Xhek Smith**

**Prokurori i Specializuar**

E martë, 17 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë.